



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

Komiteti për Komunitete

01Nr. 06-51724/ 2019

Klinë, 10. 7. 2019

30.12.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë 10. 07. 2019, në sallën e mbledhjeve.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, z. Enver Gashi, e hap mbledhjen e shtatë të Komitetit për Komunitete. Për prezencën e tyre, falënderon komandantin e Policisë, z. Rexhë Berisha, përfaqësuesit e zyrës për Komunitete dhe Kthim, OSBE, USAID dhe gjithë të tjerët. Kryesuesi prezanton Rendin e Ditës duke kërkuar debat për Rendin e Ditës dhe kërkon që të aprovohet.

Rendi Ditës:

1. Arsyetimi i mungesave
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Informim nga Policia e Kosovës, lidhur me situatën e sigurisë në Komunën e Klinës për vitin 2019.
4. Informim i përgjithshëm nga Drejtoria e Administratës
5. Të ndryshme.

Rendi i Ditës aprovohet njëzëri dhe vazhdohet me pikat e këtij Rendi. Në pikën e parë: Arsyetimi i mungesave, kryesuesi thekson se ka njoftim për vonesë të vogël të dy anëtarëve, Nexhmedin Gashit dhe Mire Ramaj, të cilët do të bashkohen së shpejti në këtë mbledhje. Ndërsa pika e dytë, rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, ky procesverbal u miratua pa asnjë diskutim, me votat e të gjithë anëtarëve, pa asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e 3 e Rendit të Ditës. Për këtë pikë fjalën e mori komandanti i Policisë në Klinë, z. Rexhë Berisha.

z. Rexhë Berisha, Komandant i PK: Përsëritet për gjithë të pranishmit. Në këtë Komitet po marr pjesë për herë të parë. Sa i përket sigurisë në Komunën e Klinës, ajo është e qetë me përjashtim të disa rasteve sporadike të natyrave të lehta. Lëvizja e lirë e njerëzve është e kënaqshme. Shqetësim i kemi shtëpitë e pabanuara sikurse ato të Komunitetit po ashtu edhe të të tjerëve. Po mundohemi që me gjithë kapacitetet që i kemi të patrullojmë sa më shpesh dhe të bëjmë sigurinë e qytetarëve dhe

pronave të tyre. Në gjashtë mujorin e parë të këtij viti janë 264 raste të iniciuara. 50 aksidente që fatbardhësisht nuk kanë qenë me fatalitet. Gjoha të vëna 201 në këtë periudhë. Persona të arrestuar kanë qenë 201. Persona të ndaluar kanë qenë 45. Armë të konfiskuara kanë qenë 32 cope dhe 1202 copë fishek të konfiskuara. Kemi bërë 30 bastisje gjithsej dhe kemi 70 legalizime të armëve, për këtë periudhë gjashtë mujore. Gjatë kësaj kohe janë realizuar 39 plane operative. Kemi pasur tre vizita të kryeministrit gjatë kësaj kohe. Jemi kujdesur për sigurinë gjatë kohës së mbajtjes së Festivalit etj. Në lidhje me Komunitetin pakicë, nuk kemi pasur raste të rënda. Ka pasur vjedhje në pronat e tyre, dëmtime të pronave por që shumica e rasteve janë ndriçuar. Me marr me %, diku tek 87% të rasteve janë ndriçuar. Jemi të ranguar në vendin e dytë si stacion në nivel regjional, sa i përket zbulueshmërisë së rasteve. Në kuadër të personelit kemi disa raste të sëmurë dhe një pjesë tjetër e policëve janë të moshuar, më gjithë këtë, ne po arrijmë që t'ju dalim në ndihmë qytetarëve të Klinës. Kemi realizuar projekte të ndryshme nëpër shkolla siç është projekti "Stop Drogërave në shkolla", pastaj "Siguria në shkolla" si dhe "Siguria në trafik". Në lidhje me rastet që i përmenda me herët si raste të natyrave të lehta, janë evidentuar si dhunë në familje, vjedhje, falsifikim, dy raste të përdorimit të drogës, armë mbajtje pa leje etj. Si vende më të rrezikshme për jetën e qytetarëve janë identifikuar: Liqeni në fshatin Sferkë, ku kemi kërkuar që të vendosen tabela informuese për rrezikun, pastaj është penda tek Lumi Drini i Bardhë si dhe ura e ngushtë dhe e rrezikshme që lidhë fshatin Dollovë me fshatin Valljak. Besoi që do të realizohen kërkesat tona që ja kemi dërguar Komunës për evitimin e këtyre rreziqeve. Bashkëpunimi me qytetarë është i mirë por kërkoi nga ju që të ndikoni në rrethet tuaja shoqërore dhe familjare që të ngritim në një nivel edhe më të madh bashkëpunimin me policinë dhe të shkëmbejmë informacione të duhura. Jemi duke punuar në preventivë dhe besoi që e kemi më mirë situatën se në Komuna të tjera. Nëse keni ndonjë pyetje, jam në dispozicion.

z. Zeqir Morina: Të gjithë jemi të shqetësuar për rrezikun nga Qentë endacak. A keni ndonjë informatë apo rast kur këta qenë kanë rrezikuar jetën e qytetarëve?

z. Rexhë Berisha, komandant i KP: Po është shqetësim i të gjithë neve. Ka shumë qenë endacak edhe në komunën tonë dhe nuk e di nëse ndonjë institucion është duke u marr me trajtimin e tyre. Kemi pasur dy raste të kafshimit. Kompetencë e kujt është, nuk e di, por qytetarët kur ju rrezikohet jeta nga qentë endacak, kanë të drejtë që të padisin komunën.

Pika e 4 e Rendit të Ditës. Në këtë pikë meqenëse mungonte drejtori i Administratës, kryesuesi e zhvendosi këtë pikë për mbledhjen e gushtit.

Pika e 5 : Të ndryshme.

z. Enver Gashi, kryesues: Dua të ju informoi se muajin gusht e kemi pushim dhe mbledhja e ardhshme do të mbahet me datë 4 shtator. Gjithashtu kemi pak problem me informimin e dy anëtarëve të Komitetit, Albanës dhe Mirës. Nuk po ju punon as telefoni dhe as emaili. Jemi munduar disa herë që të ju kontaktojmë për asgjë. Do të ju kisha lutë që të aktivizoni këto mundësi komunikimi. Mos pjesëmarrja e juaj për tre herë radhazi, ju e dini që ju nxjerr jashtë Komitetit.

znj. Silvija Raskovic: Kam një propozim në lidhje me bursat. Do të doja që të rezervohen një ose dy bursa për studentët e Komunitetit. Kemi pasur disa raste kur studentet e Komunitetit edhe pse kanë konkurruar për bursë, nuk kanë fituar për pak. E diji një prej tyre e ka pasur koeficientin 8,45.

z. Enver Gashi, kryesues: Dëshiroi që të ju informoi për punëtoritë në të cilat kemi marr pjesë ne disa , si përfaqësues të këtij Komiteti. Fjala është për punëtorinë e organizuar nga OSBE, në Prevallë, me temën “ Ngritja e kapaciteteve për përfaqësuesit e mekanizmave të mbrojtjes të Komuniteteve Komunale”, ka qenë një punëtori shumë e mirë dhe e dobishme, ku përveç meje, ka marr pjesë edhe zyra për komunitete si dhe Nexhmedin Gashi.

Znj. Silvija Raskovic: Ishte një takim i mirë në Prevallë. Punëtori shumë produktivë. Kemi mësuar diçka nga ajo që nuk e kemi ditur, kemi shkëmbyer informata dhe do të dëshiroja që të organizohen punëtori të tilla edhe në të ardhmen. Edhe një shqetësim dua ta ngris këtu. Kemi problem me KEDS. Nuk na përgjigjen në kërkesat tona.

z. Nexhmedin Gashi: Dëshiroi që ta hap një çështje. Përsëri është pranuar një punëtor në zyrën për Komunitete dhe përsëri nuk është ROM. Në atë zyre nuk është asnjë i punësuar Rom dhe si rrjedhojë nuk ka përfaqësues që mund të i mbroj të drejtat e Romëve. Edhe në lidhje me pranimin e punëtorit në aspektin administrative kam vërejtje. Nuk e kam pa që është bërë publike në web të Komunës Konkursi. Mund të them që është bërë konkurs në fshehtësi pasi që mendoi që nuk është bërë publik as në media. Do të ishte mirë që të ishte drejtori i Administratës dhe të na jep shpjegime.

Znj. Silvija Raskovic: Konkursi ka qenë publik dhe pas vendimit ka qenë një afat 30 ditor për ankesa. Mendoi që ke akoma kohë për të bërë ankesë por për të qenë ka qenë Publik.

z. Nexhmedin Gashi: Po insistoi dhe them që konkursi ndoshta ka qenë në derë të Komunës por në media dhe web të Komunës nuk ka qenë.

z. Enver Gashi, kryesues: Nëse ka ndodhë ajo shkelje është shqetësuese. Ne si Komitet të preferojmë që të bësh ankesë.

(Jashtë protokollit, këtë debat e ndihmuan Refki Krasniqi-përkthyes si dhe procesmbajtësi të cilët sqaruan afatet e konkursit, gazetën e vetme me të cilën ka kontratë Komuna dhe në të cilën bëhen publike Konkursat, afatet e ankesave si dhe në fund për informimin e saktë u tregua përmes telefonit se konkursi në fjalë ka qenë i publikuar në web të Komunës)

Kryesuesi z. Enver Gashi, duke ju dëshiruar pushime të mira verore dhe duke i informuar edhe një herë se mbledhja e ardhshme do të mbahet në shtator, e mbylli mbledhjen e VIII të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Enver Gashi